



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika d), dhe të nenit 15 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 dt. 2008”), nenit 12 të Ligjit nr. 02/L-57 për Institucionet e Kulturës (“Gazeta zyrtare e IPVQ, Nr. 11. dt. 01 prill 2007”), nenit 5. të Rregullores Nr. 01/2013 për Hartimin dhe Publikimin e Akteve të Komunave të MAPL. Nr. 0203 – 76, të dt. 24.01.2013, dhe nenit 8, paragrafi 1, e nenit 9, paragrafi 1, pika d) të Statutit të Komunës së Pejës, 01 Numër:09 – 8103 datë: 29. Shtator 2008, Kuvendi Komunal Pejë, pas procedurës së diskutimit publik, në mbledhjen e mbajtur më datë 30 janar 2015, miraton:

**RREGULLOREN KOMUNALE NR. 01/2015
PËR “SHTËPISË SË KULTURËS NË PEJË”**

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Më këtë rregullore rregullohet statusi juridik i Shtëpisë Kulturës në Pejë (në tekstin e mëtejme Shtëpia e Kulturës), veprimtaria e Shtëpisë së Kulturës, organizimi, përfaqësimi, shfrytëzimi, ofrim të ambientit të sigurt dhe sigurim të mirave materiale për të gjithë të punësuarit e shfrytëzueseve të përhershëm dhe të përkohshëm dhe transparenca.

Neni 2

2.1. Shtëpia e Kulturës është një ndër institucionet e kulturës në komunë dhe ka për qëllim t’i shërbejë zhvillimit të kulturës nëpërmjet institucioneve dhe asociacioneve të kulturës.

Neni 3.

Statusi juridik

3.1. Shtëpia e Kulturës e Pejës është pasuri publike e Komunës së Pejës dhe daton nga viti 1960 si objekt i kultures dhe është në funksion të kulturës.

Neni 4

4.1. Selia e Shtëpisë së Kulturës është në Pejë rr.Enver Hadri p.n

Neni 5

Funksionet dhe Detyrat Shtëpisë së Kulturës

- 5.1. Shtëpia e Kulturës është institucion kulturor dhe informues, që nxit dhe mundëson zhvillimin e politikave kulturore për të gjithë qytetarët e Pejës
- 5.2. Siguron qasje të lirë dhe ofron shërbim të barabartë për të gjithë qytetarët.
- 5.3. Ofron hapësira për shfrytëzim për aktivitete kulturore për asociacionet dhe institucionet e kulturës varësisht nga veprimtaria dhe të mirat që sjell për qytetarët e Komunës së Pejës.
- 5.4. Shfrytëzuesit me afat të gjatë janë vetëm institucionet që janë themeluar nga Kuvendi i Komunës ose në përputhje me ligjin për dhënie në shfrytëzim të pronës të paluajtshme të komunës.
- 5.5. Shfrytëzuesit e përkohshëm janë asociacionet që kanë kërkesë paraprake dhe lidhin marrëveshje me Drejtorinë e Kulturës Rinisë e sportit për kohë të caktuar.

Neni 6

Mirëmbajtja e Objektivit

- 6.1. Për mirëmbajtjen e përgjithshme të objektivit obligohet komuna e Pejës përmes Drejtoratit të Kulturës Rinisë dhe Sportit.
- 6.2. Asociacionet që arrijnë marrëveshje me DKRS-në për shfrytëzim për kohë të caktuar, kujdesen edhe për mirëmbajtjen hapsirave në shfrytëzim.

Neni 7

Menaxhimi i shtëpisë së kulturës

- 7.1. Shtëpia e Kulturës menaxhohet nga i punësuar (menaxheri) i cili emërohet dhe pranohet konform ligjeve në fuci për punësim në komunë.

Neni 8

Detyrat e përgjegjësit

- 8.1 Përgjegjësi i ka këto detyra dhe përgjegjësi:
 - a) Udhëheq, organizon dhe mbikëqyrë funksionimin e shtëpisë së kulturës në bazë të përshkrimit të detyrave të punë Ligjit dhe këtë rregullorë.

- b) Kujdeset për rendin shtëpiak të këtij institucioni
- c) Harton oraret për shfrytëzimin e hapësirave nga asociacionet e kulturës
- d) Mbikëqyr mirëmbajtjen e objektit,
- e) I raporton eprorit të parë administrative (shefit të kulturës) për çdo mangësi, avari ose mos disiplin.

Neni 9

Administrimi i qasjes në shtëpinë e kulturës

Në ndërtesë kanë qasje:

- 9.1. Stafi i DKRS-së
- 9.2. Të punësuarit në Bibliotekën “Azem Shkreli”
- 9.3. Të punësuarit në Radio Pejë,
- 9.4. Vizitorët e Galerisë së Arteve,
- 9.5. Anëtarët dhe lexuesit e bibliotekës,
- 9.6. Anëtarët e shoqërive dhe asociacioneve dhe përfaqësuesit e medieve që janë të vendosur në hapësirat e Shtëpisë së Kulturës,
- 9.7. Stafi politik dhe personeli ndërkombëtar, punëtor kontraktues që kryejnë punë në shtëpinë e kulturës, pjesëmarrës në intervista të gazetarëve dhe të Radio Pejës, dhe qytetar të tjerë që kanë arsye.

Neni 10

Hyrja në shtëpinë e kulturës

- 10.1. Hyrja në shtëpinë e kulturës përshin: Hyrja fizike, hyrja e lirë, e kufizuar, me qelës dhe me kartelë.
- 10.2. Në hyrje të shtëpisë kulturës është vendosur receptionisti (roje), i cili bënë identifikimin dhe evidentimin e zyrtarëve, shfrytëzuesve dhe vizitorëve tjerë.
- 10.3. Receptionisti kontakton me zyrtarin e kërkuar dhe pas pëlqimit nga ai (zyrtari), vizitorit i ndalet dokumenti i identifikimit, i jepet kartela e vizitorit dhe i hapet dera e hyrjes.
- 10.4. Receptionisti evidenton kohën e hyrjes dhe të daljes së vizitorit.
- 10.5. Përfaqësuesit politik, ushtarak dhe diplomatik përjashtohen nga këto procedura, vetëm evidentohen.

10.6. Lexuesit e bibliotekës identifikohen me libraret e anëtarësi, ndërkaq shfrytëzuesit tjerë identifikohen me kartelën e identifikimit (në bazë të orarit që është prezantuar paraprakisht)

10.5. Fletoren e receptionistit, çdo 24 orë e kontrollon dhe e nënshkruan shefi i kulturës.

10.6. Hyrjet dhe daljet e zyrtarëve dhe të gjithë shfrytëzuesve të shtëpisë së kulturës janë nën vëzhgimin e kamerave.

Neni 11

Ndalesat gjatë qëndrimit në shtëpinë e kulturës

11.1. Rreptësisht ndalohet pirja e duhanit brenda hapësirave të shtëpisë kulturës,

11.2. Rreptësisht ndalohet konsumimi i alkoolit në hapësirat e Shtëpisë së Kulturës përpos nëse ka ndonjë rast të veçante ose festë.

11.3. Rreptësisht ndalohet përdorimi i drogës dhe lëndëve narkotike,

11.4. Rreptësisht ndalohet hyrja individëve të cilët tentojnë të hyn në shtëpinë e kulturës nën ndikimin e alkoolit ose drogës si dhe të gjithë atyre që posedon, pije alkoolike dhe narkotike dhe armë.

Neni 12

Ndryshimet në strukturën (objektin) e shtëpisë së kulturës

12.1. Ndalohet ndryshimi i hapësirave dhe pajisjeve të pa lëvizshme pa njoftimin e menaxherit dhe pa lejen e DKRS-së, respektivisht sektorit të kulturës, për vazhdimin e procedurave ligjore.

12.2. Ndalohet dëmtimi i qëllimshëm i gjelbërimit, dhe hapësirës së parkingut.

Neni 13

Parkingu

13.1. Të gjithë të punësuarve në shtëpinë e kulturës ju lejohet parkimi i automjeteve në oborrin e saj, pjesa tjetër menaxhohet nga kompania e autorizuar nga Kuvendi i Komunës.

Neni 14

Sigurimi i shtëpisë së kulturës

- 14.1. Sigurimin e shtëpisë së kulturës e bëjnë pjesëtarët e kompanisë të autorizuar në bazë të procedurave të prokurimit.
- 14.2. Sigurimi fizik i hapësirave të shtëpisë së kulturës, oborrit dhe parkingut bëhet dhe monitorohet 24 orë në ditë dhe 7 ditë në javë nga personat kompetent për siguri.
- 14.3. Të gjitha kopjet e çelësave të hapësirave janë të vendosura në zyrën e receptionistit ku rrinë edhe pjesëtarët e sigurimit pas orarit të punës të punësuarve në DKRS-së.
- 14.4. Në rast të rrezikut të hapësirave të shtëpisë së kulturës, ndërhyjnë personat kompetent dhe urgjentisht njoftohen:
- a) Policia,
 - b) Zjarrfiksat,
 - c) Menaxheri,
 - d) Shefi i Kulturës
- 14.5. Numrat e kontaktit të këtyre personave duhet me qenë të vendosur në mur përballë kërrigës.

Neni 15

Dispozitat kalimtare

- 15.1. Kjo rregullore hynë fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë së Administrimit e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

01. Numer: 400 - 78715

Pejë, datë: 30. Janar 2015

KUVENDI KOMUNAL PEJË



**KRYESUESI,
Dr. Islam Husaj**